
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT**

Data 12.05.2025

Drejtuar: OE "SIGAL INSURANCE GROUP" sh.a., me Nipt J91809007H

Adr. Qendra e Biznesit SIGAL, Blv "Zogu i I", Nr. 1, Kodi postar 1001, Tiranë.

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat: _____

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

Tipi i Kontratës: **Shërbime**

Lloji i Procedurës së prokurimit: **E Hapur**

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: **REF-67264-10-30-2025.**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **"Sigurim i detyrueshëm i mjeteve motorrike të Komandës Mbështetëse te Shtabit tëPërgjithshëm të Forcave të Armatosura".**

Fondi limit: 11,874,204 (njëmbëdhjetë milion e tetëqind e shtatë dhjetë e katër mijë e dyqind e katër) **lekë.**

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 24 (njëzet e katër) muaj nga lidhja e Marrëveshjes Kuader.

Data e Publikimit në SPE të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: 27.11.2025

Data e Publikimit në Buletinin e Njoftimeve Publike të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit. Buletini Nr. 75 datë 2 Dhjetor 2025

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim ☒

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1.OE "SIGAL INSURANCE GROUP" sh.a.,

Emri i plotë i shoqërisë

J91809007H

Numri i NIPT-t

Vlera: **11,823,366.50** (njëmbëdhjetë milion e tetëqind e njëzet e tre mijë e treqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë pesëdhjetë) Lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. OE "SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP" sh.a.,

Emri i plotë i shoqërisë

J91329003O

Numri i NIPT-it

Vlera: **11,764,993** (njëmbëdhjetë milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë nëntëqind e nëntëdhjetë e tre) Lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

* * *

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1. OE "SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP" sh.a.,

Emri i plotë i shoqërisë

J91329003O

Numri i NIPT-it

Arsyet e mëposhtme:

1. Operatori ekonomik **"SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP" sh.a.**, me dokumentacionin e paraqitur vërteton **se nuk i përmbush kërkesat** për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit për arsyet si më poshtë:

Operatori ekonomik nuk plotëson kriterin 2.2.2 të seksionit 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar, lidhur me auditimin ligjor për pasqyrat financiare për shkak se:

- Totali i aktiveve të bilancit për vitet (2023, 2024), të paraqitura nga OE e kalojnë shumën prej 50,000,000 (pesëdhjetë milionë) lekësh, si dhe shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) për këtë periudhë kontabël e kalon shumën prej 100,000,000 (njëqind milionë) lekësh.

- Referuar pasqyrave financiare të paraqitura nga OE për vitet (2022, 2023, 2024), vërehet se operatori është në kushtet e plotësimit të nenit 41 të ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe të Kontabilistit të Miratuar” i ndryshuar, ku citohet se:

Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale apo të konsoliduara, përpara publikimit të tyre:

a) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësive ekonomike me interes publik;

b) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësive ekonomike, të cilat në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vjet radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

i. totali i aktiveve të bilancit në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse arrin ose e kalon shumën prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh;

ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh;

iii. ka mesatarisht të paktën 50 (pesëdhjetë) të punësuar gjatë periudhës kontabël.

Për sa më sipër, duke qenë në këto kushte OE kishte detyrimin të paraqiste bashkë me pasqyrat financiare edhe auditimin ligjor për vitet e sipërcituara në përmbushje të kriterit 2.2.2 të seksionit 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **OE “SIGAL INSURANCE GROUP” sh.a., me Nipt J91809007H**, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej: **11,823,366.50** (njëmbëdhjetë milion e tetëqind e njëzet e tre mijë e treqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë pesëdhjetë) Lekë pa TVSH, është identifikuar si ofertues i sukseshëm.

Si pasojë, nga ju kërkohet të paraqiteni tek Operatori i Blerjeve të Përqendruara me adresë : Rruga ”Reshit Çollaku”, godina nr.6/337,Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë) brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes të këtij njoftimi për të lidhur marrëveshjen.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit, nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit, nga i cili nisin afatet e ankimit

PO ☐ JO ☒ x

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR